



BASHKIA VLORE
DREJTORIA E URBANISTIKËS

RIKONSTRUKSION I RRUGËS “JAKOV XOXA ” tek Ish Frigoriferi , VLORE.

RELACION HIDROTEKNIK

DREJTORIA E URBANISTIKËS
Ingli Xhaferaj

SEKTORI I PROJEKTIMIT DHE PLANIFIKIMIT URBAN
Edmond Beqiri

PUNOI : Ing.Nermin Jonuzi
Nr Lic HT 0222/

PROJEKTI KUB NE RRUGEN “JAKOV XOXA ” **tek Ish Frigoriferi**

1. QËLLIMI I PROJEKTIT

Ky projekt hartohet me qëllim përmirësimin e infrastrukturës rrugore të Rrugës “Jakov Xoxa”, e cila shërben si aks lokal që lidh Grupin e Pallateve të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave me Rrugën Transballkanike. Projekti synon rritjen e standardeve të qarkullimit, përmirësimin e sigurisë rrugore, garantimin e kullimit të ujërave atmosferike dhe krijimin e kushteve më të mira të lëvizjes për automjetet dhe këmbësorët.



2. GJENDJA EKZISTUESE Rruga “Jakov Xoxa ”


ndodhet në një zonë me karakter kryesisht banimi individual , banim kolektiv dhe zone Sherbimi ku ndodhen disa Ndermarrje ShA si SHAUK Vlore dhe OSHEE që janë në shërbim të qytetarëve të Vlores dhe disa Subjekte private .

Traseja ekzistuese paraqitet e konsoliduar, por me problematika të evidentuara si mungesa e kullimit, gjerësi e pamjaftueshme në disa segmente, mungesë sinjalistike dhe degradim i shtresave rrugore.

GJENDJA EKZISTUESE - FOTO

HYRJA NE OBJEKT





Ndërhyrja respekton PLANIN URBANISTIK duke respektuar gjurmën ekzistuese të rrugës dhe harmonizohet me zhvillimin urban të zonës. Platforma rrugore unifikohet për të garantuar qarkullim të sigurt dhe funksional.

Trupi i rruges kryesore propozohet me gjerësi 6 m me 2 pjerresi dhe disa seksione do të jenë me një pjerresi dhe në disa me dy pjerresi, kjo në përputhje me terrenin.

Projekti KUB i BLLOKUT të banesave i rrugës "Jakov Xoxa, tek Ish Frigoriferi Vlorë. Parashikohet vetëm në aksin e rrugës me 2 pjerresi në hyrje të bllokut, në lidhjen me rrugën Transballkanike. Kurse në rastet kur gjerësia e rrugës do të jetë 3,5 m do të ketë vetëm një anë anë pas rrugës është me 1 pjerresi. Tubacionet që do të përdoren gjatë projektit janë tubacione HDPE të Brinjëzuar me SN8, me diametra $D=315\text{mm}$, $D=400\text{mm}$. Derdhja e tyre do të bëhet në Linjen Ekzistuese $\varnothing 1000$ të anës perendimore të rrugës Transballkanike, e cila

ndodhet ne fillim te rrugës Jakov Xoxa , me pusete shkarkimi 200x200x200cm si dhe me zgara shiu qe lidhen me trungun kryesor me tubo HDPE Ø 200 mm



Sipas Specifikimeve teknike

1.3 Tuba te brinjezuar HDPE

Tubat e brinjëzuar të polietilenit duhet të jenë të projektuara në përputhje me DIN EN 16961/, dhe EN 13476/3, të përshtatshme për trafik të rëndë (SLW 60), me klasën e mëposhtme të ngurtësisë dhe vlerave përkatëse të ngurtësisë së unazës (EN ISO 9969): Klasa e ngurtësisë Vlerat e ngurtësisë së unazës SN8 minimum 8 kN/m²

Tubat duhet të jenë të përbërë nga dy shtresa; të brinjëzuar nga jashtë dhe e lëmuar nga brenda. Manikotat e tubave duhet të jenë me fole dyshe dhe guarnicione EPDM ose rezistente ndaj vajit NBR. Trashësia e murit të brendshëm duhet të jetë e përshtatshme për të përballuar presionin e lartë të sistemit të pastrimit (120 bar) në përputhje me DIN 19523. Trashësia minimale e murit do të jetë në përputhje me EN 13476. Karakteristikat e materialit përbërës të tubave duhet të plotësojnë kërkesat e EN13476. Identifikimi i tubave do të bëhet gjithashtu në përputhje me EN13476.

Fleksibiliteti i unazës (aftësia për deformim pa thyerje) duhet të jetë minimumi 30%, në përputhje me EN 1446. Gjatësia e tubave të furnizuar në kantier do të jetë 6m.


1.4 Rakorderi HDPE

Rakorderitë e polietilenit duhet të jenë të projektuara në përputhje me DIN EN 16961/, dhe EN 13476/3, të përshtatshme për trafik të rëndë (SLW 60), me klasën e mëposhtme të ngurtësisë dhe vlerave përkatëse të ngurtësisë së unazës (EN ISO 9969):

Klasa e ngurtësisë	Vlerat e ngurtësisë së unazës
SN8	minimum 8 kN/m ²



Rakorderitë duhet të jenë të përbërë nga dy shtresa; të brinjëzuar nga jashtë dhe e lëmuar nga brenda. Manikotat e tubave duhet të jenë me fole dyshe dhe guarnicione

Planvendosja e trasesë së linjave KUB në rrugën e propozuar.





Detaje te prerjes terthore



PROFILI I TERITOR I PUSIES BETONI IIP 40X60X100 KANALI ME ZGARE METALIKE




PLAN I PUSIES/ ZGARE METALIKE



PRERJE E KAPAKUT TE PUSIES



JOSEDURA 15X30



Bordura e parapergalltur
Shtrise niveluese liat
Beton C16/20 f=10cm per nivelimin dhe fiksimin e bordures